



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 351/02-46975/25 dt.04.04.2025 (sipas eLeja, KKN-00158) në emër të aplikuesit Muharem Hondozi nga Prishtinë përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor/ideor, për ndërtimin e ndërtesës me destinim afarizëm, me etazhitet 2B+P+2, në kuadër të Plani Rregullues Urban “Zona Ekonomike” në Prishtinë, konkretisht parcelë është pjesë e bllokut urban ZI-12, e tërësisë Urbane ZI-12/2 si bllok me funksion “Zonë industriale”, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.1438-2 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 15.05.2025 deri më 29.05.2025, në e-mail adresën: urbanizimprishtine@rks-gov.net dhe ardian.zymeri@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesë afariste, me etazhitet 2B+P+2
b. Vija rregulluese	Rruga sipas PRRU “Zona Ekonomike”
c. Vija ndërtimore c1. Ruga Publike c2. Anët – djathtas (AD) c3. Anët – majtas (AM) c4. Pasmë	10 m, nga rruga e planifikuar P. 0.5 h / 7.18 m’ AD. 0.5 h / 6.00 m’ AM. 0.5 h / 2.50 m’
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike.	~15.00 m’ vija ndërtimore sipas “PRRU Zona Ekonomike”
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	P. 0.5H – 7.18 m’ AD. 0.5H – 6.00 m’ AM. 0.5H – 2.50 m’
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40 % (sipas PRRU Zona Ekonomike”) ~ 40 % e propozuar.
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	40 % (sipas PRRU Zona Ekonomike”) ~ 40 % e propozuar.
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40 % e lejuar sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 dt 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës ~ 40 % e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60 % (sipas PRRU Zona Ekonomike”) ~ 45.21 % e propozuar.
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	4-VP / 100 m ² për afarizëm. 2-VP / 100 m ² për administrative.
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafi 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____